



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 145, datë 20.10.2017

PËR
NJË SHITESË NË FONDIN E KOMPENSIMIT TË VITIT 2017

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, si dhe nenit 58 e vijues të Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E:

Bordi i Autoritetit gjatë vitit 2017, ka marrë 2 vendime lidhur me Fondin e Kompensimit përkatësisht:

Vendimin nr. 5, datë 03.02.2017 “Për marrjen e masave lidhur me Fondin e Kompensimit”, si dhe Vendimin nr. 26, datë 30.03.2017 “Mbi Fondin e Kompensimit për vitin 2017”, në të cilat janë vendosur:

- Shuma prej **79,744,636 lekë dhe 468,000,000 lekë** - për pagesat e dëmeve që u përkasin ngjarjeve të sigurimit deri më datë 31.12.2013;
- Shuma minimale prej **41,572,303 lekë dhe 157,042,463 lekë** - për pagesat e dëmeve që u përkasin ngjarjeve të sigurimit nga data 1 janar 2014 e në vazhdim.

Përsa më sipër, sipas këtyre 2 vendimeve, Fondi i Kompensimit për vitin 2017, paraqitet:

Fondi i Kompensimit për ngjarjet deri 31.12.2013	547,744,636 lekë
Fondi i Kompensimit për ngjarjet pas 1 janar 2014	198,614,765 lekë

Lidhur me problematikën e Fondit të Kompensimit, Autoriteti ka patur komunikime të vazhdueshme me shoqëritë e sigurimit, duke kërkuar në veçanti dhe angazhimin e tyre.

Autoriteti konsideron shumë të rëndësishme, rradhën e pagesave të dëmeve të Fondit të Kompensimit për ngjarjet deri 31.12.2013, duke patur parasysh periudhën më të hershme të ndodhjes së ngjarjes, të cilat fillojnë nga viti 2002. Duke filluar nga muaji korrik 2017, është bërë shpërndarja e praktikave të dëmeve për ngjarjet 2002-2008, për të cilat Byroja ka lëshuar autorizimet për pagesë.

Në vijim të këtij procesi, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, referuar detyrimeve të konsiderueshme të Fondit të Kompensimit, në funksion të përmbushjes së kompetencave të përcaktuara në ligj, me qëllim mbrojtjen e interesave të konsumatorit, për shlyerjen në një kohë sa më të shkurtër të detyrimeve të Fondit të Kompensimit për praktikën e dëmeve me ngjarje sigurimi më të hershme 2009-2011, parashikon të domosdoshme nevojën për shtesë të fondit të vitit 2017.

Për sa më sipër, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Bazuar në nenin 12, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, si dhe nenin 58 e vijues të Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, duke qenë se Fondi i Kompensimit i miratuar për vitin 2017, është i pamjaftueshëm për të kryer pagesat e dëmeve për ngjarjet e sigurimit deri më 31.12.2013, miratohet Fond Kompensimi shtesë në vlerën 250 milionë lekë.
2. Të urdhërohet Byroja Shqiptare e Sigurimit të shpërndajë dhe të dërgojë menjëherë autorizimet për ndjekjen e procedurës së pagesës pranë shoqërive të sigurimit për praktikën e dëmeve me ngjarje sigurimi më të hershme.
3. Moszbatimi i këtij vendimi, do të jetë objekt i masave administrative të parashikuara në ligj.
4. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin KOÇI